



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

Kodi: 032

**KEC**

## **EDUKIMI MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK**

*Trajnimi për trajnerë për edukimin multikulturor dhe multietnik*

### Qëllimet e programit

Pas përfundimit të trajnimit pjesëmarrës – trajnerët e certifikuar do të jenë në gjendje:

- T'i përshkruajnë, t'i shpjegojnë dhe të demonstrojnë njohje për konceptet themelore që kanë të bëjnë me edukimin, ndër dhe multikulturor si dhe ndër dhe multietnik
- Të demonstrojnë njohuri dhe dituri të qëndrueshme për aspektet dhe mundësitë e ndryshme të edukimit ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik
- Të shpjegojnë dhe të argumentojnë rolin që ka arsimit cilësor për të gjithë për edukimin dhe arsimimin ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik
- Të demonstrojnë dije dhe aftësi për rolin dhe rëndësinë që ka edukimi ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik për mbrojtjen dhe ruajtjen e paqes
- Të tregojnë dije dhe aftësi për tipat kryesore të konflikteve ndër dhe multikulturore dhe ndër dhe multietnike
- Të shpjegojnë, argumentojnë dhe të dallojnë etiologjinë e konflikteve të bazuara në identitete etnike
- Të demonstrojnë aftësi për edukimin dhe arsimimin e të rinjve për zgjidhje paqësore të konflikteve
- Të tregojnë aftësi për identifikimin dhunës sidomos të asaj strukturore dhe luftimin saj
- Të tregojnë aftësi për identifikimin e paragjykimeve dhe të stereotipave kulturor dhe etnik
- Të tregojnë aftësi për organizimin e aktiviteteve të edukimit dhe të arsimimit ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik

- Të demonstrojnë dije për instrumentet dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve, si dhe për edukimin dhe arsimimin për ndërtimin e paqes dhe të pajtimit ndëretnik dhe ndërkulturor

### Përmbajtja

1. **Gjuha e të drejtave të njeriut** - Diversiteti kulturor dhe etnik ka një gjuhë komunikimi. Kjo gjuhë universale komunikimi është GJUHA E TË DREJTAVE TË NJERIUT. Ku shtrihet kjo gjuhë komunikimi në projektet dhe aktivitetet e KEC-it. Impakti i kësaj gjuhe në efikasitetin dhe efektivitetin e brendshëm të arsimit. Ndikimi i Gjuhës së drejtave të njeriut në krijimin e një shoqërie miqësore me njeriun në qendër, në zhvillimin ekonomik, shëndetësor, dhe në Indeksin e Zhvillimit Njerëzor
2. **Paketa e edukimit ndër dhe multikulturor si dhe ndër dhe multietnik** - Sigurimi i Arsimit Cilësor për të gjithë. Koncepti i arsimit cilësor për të gjithë. Arsimi Cilësor për të gjithë dhe instrumentet dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut dhe edukimin dhe arsimimin ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik, Ndërlidhja e sistemit të arsimit cilësor për të gjithë dhe të arsimit ndërkulturor dhe multikulturor dhe ndëretnik dhe multietnik.
3. **Konceptet themelore lidhur me edukimin ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik** - Përkufizimet themelore, tipat e konflikteve ndëretnike, llojet e integriteteve, shkaqet dhe pasojat e konflikteve ndëretnike dhe ndërkulturore. Si të ndërtohet “shtëpia“ në të cilën të gjithë do të jetojnë në paqe, harmoni dhe mirëkuptim?
4. **Edukimi për paqe** - Irenika - shkenca mbi paqen. Roli irenik i edukatës dhe i arsimit për ndërtimin e paqes, përmasat e paqes. Koncepti i paqes, llojet e paqes, instrumentet themelore për ndërtimin e paqes
5. **Dhuna** - Koncepti i dhunës, llojet e dhunës, faktorët që nxisin dhunë, pasojat e dhunës, identifikimi i dhunës, parandalimi i dhunës
6. **Konfliktet dhe zgjidhja jo e dhunshme e konflikteve** - Koncepti i konflikteve, konfliktet dhe jeta, shkaqet e konflikteve, tipat e konflikteve, natyra e zgjidhjes së konflikteve, mënyrat e zgjidhjes së konflikteve, negociimi dhe konsensusi, edukimi dhe arsimimi për trajtimin dhe zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve komunikimi dhe zgjidhja e konflikteve, aftësitë komunikuese, pengesat në komunikim, hapat-etapat për zgjidhjen e konflikteve
7. **Edukimi dhe arsimimi për luftimin e paragjytimeve dhe të stereotipave kulturor dhe etnik** - Konceptet themelore për paragjykimet dhe stereotipat kulturor dhe etnik, identifikimi i stereotipave dhe të paragjytimeve, procesi i formimit të paragjytimeve dhe të stereotipave
8. **Fushat, mënyrat, përmbajtjet e dhe format e edukimit ndër dhe multikulturor dhe multietnik** - Ndërtimi i godinës së përbashkët, kur duhet të fillon edukimi ndër dhe multikulturor dhe multietnik, parimet themelore mbi të cilat duhet të realizohet edukimi ndër dhe multikulturor dhe ndër dhe multietnik, format e edukimit, metodat, fushat etj.

9. **Dokumentet, standardet dhe instrumentet mbi të cilat bazohet edukimi ndër dhe multikulturor dhe multietnik** - Dokumentet themelore ndërkombëtare dhe kombëtare, standardet e miratuara, instrumentet e monitorimit.
10. **Profili i trajnerit për edukim dhe arsimim ndër dhe multikulturor dhe multietnik** - Sfidat kryesore, ç'është trajneri për edukimin multikulturor dhe multietnik, Cila është puna e trajnerit?

#### Grupi i synuar

Ky program u dedikohet trajnerëve për të drejtat e njeriut/fëmijës, zyrtarëve të arsimit në Zyrat Rajonale të Arsimit, administratorëve, voluntarëve, dhe fasilitatorëve për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, juristëve, policëve, studentëve dhe pedagogëve universitarë.

#### Forma e organizimit/ kohëzgjatja

Programi për aftësimin e trajnerëve për edukimin dhe arsimimin ndër dhe multikulturor, si dhe ndër dhe multietnik organizohet në formën e kursit 7 ditor me gjithsej 49 orë.

#### Certifikimi

Certifikimi për trajnerë bëhet në dy nivele:

1. Certifikimi për pjesëmarrje
2. Certifikimi për trajnerë

Kriteret për certifikim janë: pjesëmarrja në trajnime, dosja me punime të përgatitura dhe njohjet dhe aftësitë e shpalosura në intervista.